



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.03.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Spartak Braho – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 05.03.2014.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”.
3. Projektligji “Për dhënie amnistie”.

Marrin pjesë:

Spartak Braho, Piro Lutaj, Arben Çuko, Armando Prenga, Paulin Sterkaj, Shkëlqim Selami, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Taulant Balla, Luan Rama, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Armando Subashi, Ardian Turku, Flamur Noka, Alban Zeneli, Aqif Rakipi, Ylli Shehu, Astrit Patozi, Keltis Kruja dhe Helidon Bushati.

Mungojnë:

Mesila Doda dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Edlira Krypa - drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Argita Alikaj - shefe e Sektorit të Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Zoto - drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Sokol Pasho - drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Spartak Braho - Fillojmë mbledhjen e komisionit.

Po, zoti Rama

Luan Rama - Për procedurë, në një nga mbledhjet e para të komisionit, kur kemi diskutuar projektligjet, unë kam propozuar dhe insistuar se kur ka projektligje të rëndësishme, ministritë duhet të përfaqësohen me titullarin. Ligjet “Për amnistinë” dhe “Për Policinë e Burgjeve” janë ligje shumë të rëndësishme për të cilat, pavarësisht se jemi komisioni për dhënie mendimi, unë personalisht kam disa propozime që kanë të bëjnë me thelbin e politikës së amnistisë. Unë e gjykoj që në mos ministri, duhet të jetë i pranishëm zëvendësministri.

Spartak Braho - Ministri Naço më tha dje se do të ishte në një aktivitet ku duhet të ishte prezent, prandaj kanë ardhur drejtorët dhe përfaqësues nga kjo ministri. Zëvendësministrat janë jashtë shtetit, por ata nuk dinë më shumë sesa këta që janë të pranishëm.

Pra, këtë dua të them, se zoti Naço, ma kërkoi këtë gjë që dje. Unë i thashë se do të vija në dijeni komisionin, por nëse doni të pezullojmë mbledhjen deri sa të vijë ministri...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Rama - Meqenëse unë e kam ngritur këtë shqetësim dhe si komision kemi rënë dakord, kjo është shenjë respekti për komisionin. Ishte i ngarkuar zoti Naço, por një zëvendësministër nuk do të ishte keq të vinte.

I kërkoj sekretarisë të dokumentojë atë që thatë ju se zëvendësministrat nuk marrin vesh.

Spartak Braho - Nuk është nevoja, sepse ua themi në sy.

Ardian Turku - Problemi që ngre kolegu është i drejtë dhe duhet ta kemi parasysh për herë tjetër. Nuk është nevoja të ngatërrojmë me vizitën e fundit, sepse edhe seanca plenare...nuk kishte lidhje fare, por ta vazhdojmë mbledhjen meqenëse janë titullarët e institucioneve, për të mos bërë një shtyrje tjetër.

Spartak Braho - Fillojmë me projektligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

Po, zoti Lutaj.

Piro Lutaj - Kolegë të nderuar, ne jemi duke dhënë mendimin për projektligjin “Për Policinë e Burgjeve”. Komisioni i Ligjeve, një pjesë e jona janë anëtarë edhe në këtë komision, është duke e diskutuar dhe kemi rënë dakord që të bëhet një rakordim midis zyrës së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë dhe disa deputetëve të Komisionit të Ligjeve, të cilët kanë dhënë

mendimet e tyre. Unë do të kërkoja nga ky komision, që t'i drejtohem Komisionit të Ligjeve që gjatë analizës nen për nen që do t'i bëjë këtij projekti të ndalet pak në nenin 20 të ligjit ekzistues, për të harmonizuar kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe te neni 14 i nenit ekzistues ku bëhet fjalë për kohën e punës dhe të pushimit, pasi administrata shtetërore, pjesë e së cilës është edhe Policia e Burgjeve e kanë të përcaktuar këtë gjë, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave të vitit 2011 dhe të Ministrisë së Financave të vitit 2011. Pra, meqenëse Polica e Burgjeve është pjesë e administratë shtetërore, kjo strukturë, për sa i përket kohës së punës dhe të shërbimit, duhet të trajtohet në bazë të këtyre dy vendimeve.

Për pjesën tjetër, unë e konsideroj një ligj komplementar i cili shkon me të njëjtin sens me ligjin që po diskutojmë në Komisionin e Ligjeve për trajtimin e të dënuarve me burgim në Republikën e Shqipërisë. Unë do t'i formatoj këto dy objeksione dhe do të preferoja që kryetari i Komisionit t'i hidhte në votim ato, për t'ia dërguar Komisionit të Ligjeve si mendime të dala nga komisioni ynë.

Spartak Braho - Po, zoti Rama.

Luan Rama - Është një iniciativë për t'u përshëndetur fakti që vijnë propozime për të bërë disa ndryshime përmirësuese në ligjin "Për Policinë e Burgjeve", por duke parë me vëmendje projektin, vërej se ka disa mospërputhje ose inkoherenca. Mbase e kam gabim, por për të sqaruar edhe kolegët, kam disa pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë ose edhe për relatorin.

Në nenin 3, pika 4 thuhet: "Punonjësit e Policisë së Burgjeve, janë pjesë e administratës publike", ndërkohë që në nenin 7 thuhet: " Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës, trajtimi dhe trajnimi i ecurisë në karrierë, ndërprerjet e marrëdhënieve të punës përcaktohen në rregulloren e personelit të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave". Po Kodi i Punës dhe ligji "Për administratën publike" çfarë autoriteti kanë në rastin konkret? Nëse Policia e Burgjeve është pjesë e administratës publike, e gjithë pjesa që përshkruan neni 7 për rregullat dhe procedurat e punës, trajnimin dhe ecurinë në karrierë, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, apo marrjen në punë, duhet t'i nënshtrohen Kodit të Punës dhe ligjit "Për administratën publike". Si rregullohet kjo mospërputhje?

Në nenin 8, pika 4 thuhet : "Struktura e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve në nivelin e IEVP-së është pjesë e strukturës dhe organikës së çdo IEVP-je". Në aspektin gjuhësor këtu ka

një lajthitje, sepse struktura më e madhe nuk mund të jetë pjesë e strukturës më të vogël. Ndoshta jam gabim, por hartuesit e draftit mund të na e shpjegojnë këtë gjë.

Në nenin 15, pika 2 thuhet: “Paga mujore e punonjësit të Policisë së Burgjeve përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradën, dhe nga shtesat e tjera referuar kushteve të punës dhe funksionit përkatës. Nuk thuhet, edhe nëse është e nënkuptuar, jo të gjithë mund ta nënkuptojnë, se çfarë vendi zënë në këtë rast vjetërsia dhe kualifikimi profesional, titujt dhe gradat shkencore.

Në nenin 19, germa “a” thuhet: “Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet personi që, krahas kriterëve të përgjithshme, sipas nenit 17 të këtij ligji, plotëson edhe këto kriterë të veçanta, të ketë arsim të lartë. Çfarë arsimi të lartë mund të ketë? Mund të jetë veteriner, agronom, mësues e nuk e di se çfarë?

Për pikën 2 të nenit 15, nën paragrafin 1, ku thuhet: “Punonjësi i Policisë së Burgjeve lirohet nga detyra kur jep dorëheqjen, mbush moshën e pensionit, humbet aftësinë, shkërtohet funksioni” e të tjera, unë kam një pyetje: Po kur dënohet një i afërm i tij, si vëllai, babai ose motra, dhe ky është punonjës i Policisë së Burgjeve, çfarë qëndrimi mban ligji ndaj këtij personi? Sepse pastaj kemi të bëjmë me konflikt interesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Duhet të përcaktohet në ligj.

Flamur Noka - Duhet të jetë e përcaktuar.

(Diskutime në sallë.)

Luan Rama - Epo një drejtor burgu, nuk mund të rrijë drejtor burgu, kur ka vëllanë të burgosur aty?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po një drejtor i Përgjithshëm, kur ka vëllanë në burg, ku transferohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nejse, unë po pyes specialistët, pastaj...

Në pikën 8 të nenit 19, kur flitet për vjetërsinë për efekt të gradës, thuhet: “Llogaritet koha gjatë së cilës ai ka kryer shërbim aktiv në strukturat e Policisë së Burgjeve...” Po nëse ka qenë në Policinë e Shtetit, në Policinë Ushtarake ose në Forcat e Armatosura dhe vjen në Policinë e Burgjeve, si llogaritet vjetërsia? Këto janë pyetjet që kam.

Spartak Braho - Fjalën e ka zoti drejtor.

Artur Zoto - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë...

Spartak Braho - Ne dimë që ka qenë zoti Lutaj atje.

Piro Lutaj - Ja t'ju them diçka në lidhje me këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në rregull, por unë marr përsipër atë që kam thënë...

Luan Rama - I dashur Piro, meqenëse pyetjet i bëra unë, unë nuk kam qenë në Komisionin e Ligjeve dhe nuk e di se çfarë është diskutuar atje...

Piro Lutaj - Nuk po shpjegoj ...

Luan Rama - Unë kam pyetje për specialistin, jo për ju, ndaj le të flasë specialisti.

Piro Lutaj - Nuk po ju sqaroj ju, nuk po u përgjigjem pyetjeve tuaja, unë po sqaroj thënien e zotit Patozi, që Komisioni i Ligjeve, është e vërtetë, ka bërë një azhurnim të problematikës që e kam këtu. Unë ju kërkova, shkurtimisht thashë, që të marrim azhurnimet e miratuara nga Komisioni i Ligjeve dhe të vijmë këtu nen për nen. Të miratojmë ligjin në parim, kjo ishte ideja që po thosha. Ju keni bërë pyetje nen për nen.

Flamur Noka – Zoti kryetar, mund të them diçka?

Piro Lutaj – Ne nuk po diskutojmë nen për nen tani.

Flamur Noka – Çështja është që të gjitha rekomandimet që ka bërë Komisioni i Ligjeve duhet të azhurnoheshin në draftin e sjellë në Komisionin e Sigurisë, pastaj ne mund të fillojmë t'i diskutojmë.

Spartak Braho – T'i shohim nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Flamur Noka – Ne hymë nen për nen, sepse fakti që u bënë pyetjet nen për nen...

Spartak Braho – Nuk kemi hyrë ende nen për nen.

Flamur Noka – ...do të thotë që kemi vazhduar. Por edhe drafti në përgjithësi, edhe drafti që kemi përpara është pa ndërhyrjet e bëra në Komisionin e Ligjeve. Sigurisht, për mendimin në përgjithësi ne do të referohemi te problematika që ngriti zoti Rama, sepse e kemi parë, e dimë pak a shumë dhe fokusohemi tek ato çështje, shqetësime ose pyetje që ngriti zoti Rama. Kështu që ne kemi të drejtën të themi që, disa nga këto pika, ku ka paqartësi, është e mundur që Komisioni i Ligjeve t'i ketë marrë në konsideratë dhe t'i ketë korrigjuar, t'i ketë redaktuar ose rregulluar.

Ne nuk e dimë këtë gjë, por mund ta dijë zoti Lutaj, sepse është anëtar i Komisionit të Ligjeve. Zoti Lutaj është i barabartë me ne këtu dhe nuk ka të drejtë të na sqarojë, po të ishte në panel atje bashkë me zotërinjtë sigurisht mund të na sqaronte. Por fakti që ata zotërinj e kanë për detyrë të na sqarojnë, do të thotë që ata duhet të vijnë me projektin e ndryshuar nga Komisioni i Ligjeve dhe pastaj ne mund të fillojmë diskutimin, pasi mund të ndodhë që, për të njëjtat çështje që Komisioni i Ligjeve i ka marrë në shqyrtim dhe i ka redaktuar, i ka rregulluar ose përmirësuar, mund të bëjmë debat kot dhe shumë të gjatë.

Të përgjigjet zotëria dhe ta sqarojmë.

Spartak Braho - Tani, në këtë komision janë gati 8 deputetë që janë pjesëtarë të Komisionit të Ligjeve. Pasi ta votojmë në parim, do ta shqyrtojmë projektligjin nen për nen, duke iu referuar ndryshimeve që janë bërë në Komisionin e Ligjeve (do ta bëj unë, do ta bëjë Piro, do ta bëjë Armando) dhe mbi bazën e tyre do të diskutojmë. Pra, do të njihemi me ndryshimet që janë bërë në Komisionin e Ligjeve, se ky është problemi, se ç'farë kanë bërë ata. Ne kemi të drejtë të propozojmë ndryshime, por jemi komision mbështetës, komision që japim një miratim, gjë që nuk na pengon të propozojmë edhe ndryshime të tjera. Pastaj është seanca plenare ajo që do të vendosë nëse do të pranojë ndryshimet e Komisionit të Ligjeve, do të vendosë ndryshimet e propozuara nga ne...

Prandaj për të mos u vonuar, ia japim fjalën drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Artur Zoto - I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar zotërinj deputetë,

Paraprakisht, në vazhdim të pyetjeve të bëra nga deputeti Rama, desha të shtoj diçka. Sigurisht, ndryshimet legislative që kemi sjellë këtu para jush janë pjesë e një procesi të ndërmarrë nga Ministria e Drejtësisë për përafrimin e legjislacionit, në veçanti të legjislacionit që lidhet me veprimtarinë e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale në vendin tonë, me standardet dhe kërkesat e Bashkimit Europian.

Dua të shtoj diçka. Ne do t'i referohemi ligjit, do ta marrim ligjin si një të tërë, në mënyrë që të kuptojmë ndryshimet dhe risitë të cilat kemi menduar t'i prezantojmë në këtë nismë ligjore. Konkretisht, ligji është pak a shumë, i ndërtuar në 4 pjesë, ku përmbledh pjesën e përgjithshme; pjesën që lidhet me organizimin dhe funksionimin e këtij lloj shërbimi; pjesën që është shumë e rëndësishme për këtë strukturë, karrierën, trajtimin, si dhe pjesën që lidhet me nenet e

përgjithshme për të bërë mbylljen e këtij akti ligjor. Pra jemi të gatshëm të përgjigjemi edhe në parim, edhe nën për nën.

Pyetjet e bëra nga zoti Rama, konkretisht, po i marr pyetjet një nga një.

Lidhur me pyetjen e parë, a ka mospërputhje mes përkufizimit ose qartësimit që i bëjmë në kësaj strukture si pjesë e administratës publike dhe a duhet të shtojmë aty që marrëdhëniet rregullohen me Kodin e Punës, po ta shikoni, ne kemi shtuar që marrëdhëniet e kësaj strukture rregullohen me një vendim të Këshillit të Ministrave, me Rregulloren e Personelit, e cila nuk ka ekzistuar. Aktualisht, pse e kemi bërë këtë shtesë? E kemi bërë këtë shtesë duke marrë në konsideratë debatin e madh që është bërë edhe në vitin 1999, edhe në vitin 2007 për ndryshimet e bëra në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, të cilin e kemi marrë për ekuivalentim për ta cilësuar edhe këtë strukturë si pjesë të administratës publike, për të shmangur edhe debatin e bërë pas vitit 1999 në lidhje me të ashtuquajturën të pasura me ekzistencën e këtyre strukturave në shërbimin ushtarak apo forca të Armatosura ose jo, dhe për t’i bërë ato struktura civile. Po jua sjell në vëmendje atë debat se prandaj është bërë ky përkufizim në këtë nën, për ta quajtur këtë strukturë pjesë të administratës publike.

Lidhur me pyetjen nëse kjo strukturë ka nevojë që marrëdhëniet e saj të rregullohen me Kodin e Punës, unë mendoj që ky është një ligj i veçantë, ku tek objekti dhe te misioni që kemi përcaktuar, kemi thënë: “rregullon marrëdhëniet dhe funksionimin e strukturës ose Policisë së Burgjeve në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”. Ky ligj nuk do të mjaftohet me kaq. Implementimi i tij është i lidhur edhe me hartimin dhe miratimin e një sërë akteve nënligjore, si i tillë është edhe vendimi i Këshillit të Ministrave për miratimin e një rregulloreje të personelit.

Kështu që Rregullorja e Personelit...

Spartak Braho - Duhet të kuptoni këtë gjë, thelbi i pyetjes së zotit Rama ishte: këta janë pjesë e administratës publike?

Artur Zoto - Patjetër janë pjesë e administratës publike dhe prandaj marrëdhëniet do të rregullohen me një rregullore personeli.

Spartak Braho - Prisni, një herë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Marrëdhëniet e punës nuk rregullohen me rregullore. Po të jenë pjesë e administratës, do të rregullohen në bazë të ligjit përkatës.

Ne nuk na pengon të shtojmë aty, nuk e di si e mendoni ju, që rregullohen me ligjin që rregullon atë, pastaj rregullohet ...

Dakord, zoti Rama?

Luan Rama - Ka një specifikë. Ka dy mënyra ose dy norma me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës në një institucion, ose me ligjin “Për administratën publike” ose, kur është institucion që ka ligj organik, po marr shembull Policinë e Shtetit, rregullohen në bazë të ligjit organik. Marrëdhëniet e punës nuk mund të rregullohen as me vendim të Këshillit të Ministrave, as me rregullore dhe me asnjë akt tjetër nënligjor. Akti nënligjor del në zbatim të ligjit dhe mund të mos jetë fare në ligj. Në rast se (unë jam dakord që Policia e Burgjeve të jetë pjesë e administratës publike) përcaktohen marrëdhëniet e punës dhe e gjithë karriera bazohen në ligjin “Për administratën publike”, këtu mbaron diskutimi për këtë çështje. Pastaj ligji “Për administratën publike” ka detyrimin që qeveria dhe institucionet e tjera të nxjerrin aktet nënligjore e të tjera, është tjetër gjë ajo pastaj, sepse rregulloret mund të ndryshojnë sa herë ndryshon Kryeministri ose ministri, ndërsa ligji ka tjetër peshë dhe tjetër tagër.

Flamur Noka - Rregulloret janë përgjithësisht për funksionimin e brendshëm, nuk kanë të bëjnë me marrëdhëniet e punës.

Luan Rama - Domethënë, koncepti që marrëdhëniet e punës ndërtohen me rregullore është anakronik dhe jashtë frymës së një administrate moderne e europiane.

Spartak Braho - Sokol, mendoni si duhet të rregullohet dhe le të ecim.

A jeni dakord në parim me vërejtjen?

Artur Zoto - Ky është një ligj organik, që rregullon funksionimin e strukturës së shërbimit të policisë në burgje dhe, si i tillë, prandaj është shtuar, aty është marrë ekuivalentimi nga ligji “Për Policinë e Shtetit”, i cili i është nënshtruar një procesi të gjatë konsultimi. Kështu që mendoj se ligji nuk ka asnjë problem dhe e shpreh shumë qartë këtë gjë.

Luan Rama - Në rast se këtu do ta barazojmë strukturën e Policisë së Burgjeve me atë të Policisë së Shtetit, atëherë ndryshojmë komplet rrafshin mbi të cilin ndërtohet diskutimi. Unë personalisht jam për ta barazuar strukturën e Policisë së Burgjeve me Policinë e Shtetit dhe punonjësi i Policisë së Burgjeve të ketë të njëjtin status që ka ai i Policisë së Shtetit në karrierë, në mbështetje ligjore, në bazë dhe në çdo gjë. Ju keni zgjedhur të veprohet me ligjin për administratën publike.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E di se Policia e Shtetit është pjesë e administratës publike, sepse nuk është më pjesë e Forcave të Armatosura, por ka një ligj të veçantë që ka një status të veçantë. Policia e Shtetit dhe Shërbimi Informativ Kombëtar kanë një ligj që u jep atyre një status të veçantë, të dallueshëm nga pjesa tjetër e administratës publike. Karriera në ato institucione dhe marrëdhëniet e punës nuk bazohen në ligjin për administratën publike, por në atë “Për Policinë e Shtetit”. Në rast se do të ecim që struktura e Policisë së Burgjeve të ketë statusin e administratës publike, karriera, marrja në punë dhe largimi nga puna bazohen në ligjin për administratën publike. Kjo është një plus një bëjnë dy, nuk ka tre në këtë rast.

Paulin Sterkaj - Unë mendoj se ky ligj mund të jetë i përkohshëm. Ndoshta ka ardhur koha që këtë ta kalojmë, sepse në parim ishim të gjithë dakord të bënim një ligj ekstra për Policinë e Burgjeve. Pra, ta rregullojmë në kompleks, sepse ligji është, por sot po bëjnë një ndërhyrje dhe nesër një tjetër. Përderisa deri sot nuk ka funksionuar ashtu siç duhet, le të bëjmë një ligj për të funksionuar Policia e Burgjeve. Atëherë pse të mos e bëjmë një ligj në kompleks, që të funksionojë në këtë institucion, siç është bërë për Policinë e Shtetit dhe për Shërbimin Informativ.

Spartak Braho - Artur, ju jeni një strukturë që vareni nga ministri i Drejtësisë, që do të thotë se funksionimi dhe varësia e ligjit organik varen nga Ministria e Drejtësisë, ju jeni organ nën të, në ndryshim me atë që thanë parafolësit.

Zoti Rama, Policia e Shtetit është strukturë më vete dhe ka ligj të veçantë për organizmin dhe funksionimin e saj. Nuk jemi në kushte të barabarta me Policinë e Burgjeve, prandaj zoti Sterkaj po e bën propozimin.

Megjithatë, me vërejtjen që bëhet, pse hezitoni?

Artur Zoto - Nga ana jonë nuk ka asnjë lloj hezitimi, por nuk po kuptohet thelbi ose mesazhi që ne kemi dashur të përcjellim me anë të asaj pjese, që struktura është pjesë e administratës publike.

Luan Rama - E kalojmë ligjin kështu siç e keni sjellë ju, pas këtij ligji, punonjësit e Policisë së Burgjeve për t’u marrë në punë do të kalojnë në Departamentin e Administratës Publike, apo do t’i emëroni ju?

Artur Zoto - Nëse e quajmë diçka risi, risi është edhe procedura dhe mënyra e rekrutimit. Po të shikoni në nenet e mëposhtme, atje përcaktohen qartë edhe mënyrat e

rekrutimit. Punonjësit që do të merren do t'u nënshtrohen kriterëve ose kërkesave të përcaktuara nga ky ligj.

Luan Rama - Jo nga ligji për administratën publike.

Spartak Braho - Edhe njëherë, sepse jemi të paqartë, te pika 4 e nenit 3 thuhet: “Punonjësit e Policisë së Burgjeve janë pjesë e administratës publike”.

Pse e keni vënë këtë?

Artur Zoto - Siç e thashë, për të bërë atë ndasinë ndërmjet konceptit, sepse kjo strukturë është me uniformë, por ka edhe struktura që kanë të drejtën e armës. Pra, për të bërë dallimin midis pjesës civile dhe asaj për të mos qenë pjesë e forcës ushtarake.

Spartak Braho - Nuk ka lidhje fare kjo.

Pse e keni ngatërruar veten me këtë dispozitë këtu? Kjo na ngatërroi, e keni bërë pjesë të administratës publike, që ka detyrim ligji mbi administratën publike.

Artur Zoto - E përmenda paraprakisht debatin që është bërë në vitin 1999. Nëse nuk do të kishim këtë pikë, do të na ngatërronte.

Luan Rama – Zoti kryetar, ndoshta duhet të bëhet një sqarim tjetër: punonjësi i Policisë së Burgjeve të gëzojë statusin e administratës publike, por jo të jetë pjesë e saj. Nëse është pjesë e administratës publike, i gjithë autoriteti i rekrutimit, i marrëdhënieve të punës dhe i largimit nga puna kalon tek administrata publike, sepse është ligj që prevalon në hierarkinë juridike me ligjin “Për Policinë e Burgjeve”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E ka të specifikuar në ligj Policia e Shtetit, por ka status të veçantë. Ndërsa ti nuk jep status të veçantë, por atë të administratës publike.

Spartak Braho - Urdhëroni!

Edlira Jorgaqi - Faleminderit, zoti kryetar!

Më duhet të sqaroj zotin Rama se parashikimi i kësaj pike, pra të pikës 4 të nenit 3 të ligjit, që punonjësit e Policisë së Burgjeve janë pjesë e administratës publike, nuk do të thotë domosdoshmërisht se këta punonjës të Policisë së Burgjeve gazojnë statusin e nëpunësit civil. Janë dy koncepte të ndryshme. Ndoshta kjo është ajo pika ku ka ngecur edhe debati. Është tjetër gjë të thuash administratë publike, që është administrata e gjithë shtetit, dhe tjetër gjë të thuash nëpunës civil. Janë komplet të ndryshme. Nëpunësi civil është baza ligjore që ju përmendët. Pra është ligji “Për nëpunësin civil” që e rregullon shprehimisht, por ka edhe punonjës në

administratën publike që nuk e gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe nuk u nënshtrohen dispozitave të ligjit “Për shërbimin civil”.

Konkretisht, zoti Rama, është ligji për administratën shtetërore, që e ka rregulluar me detaje pjesën e administratës publike. Ndërsa nëpunësi civil është legjislacion tjetër, ka dy baza të ndryshme ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk është e njëjta gjë, zoti Rama. Nëpunësi civil është pjesë e administratës publike.

Luan Rama - Më thoni cili është ligji për administratën shtetërore?

Edlira Jorgaqi - Ligji për administratën shtetërore është ai nr. 90, i vitit 2012 “Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore”. Ndërsa ligji “Për statusin e nëpunësit civil” është ai i muajit maj të vitit 2013. Baza ligjore është e ndryshme në të dyja konceptet.

Flamur Noka - Kanë objekt të ndryshëm. E rëndësishme është të sqarohet objekti, sepse ai është i ndryshëm. Nëpunësi civil ka tjetër objekt, ndërsa administrata përcaktohen se kush përfshihet në të, çfarë quhet administratë dhe si funksionon.

Luan Rama - Atëherë duhet bërë që Policia e Burgjeve është pjesë e administratës shtetërore që unison me termin e ligjit.

Edlira Jorgaqi - Në fakt, terminologjia e përdorur është në përputhje me ligjin për administratën shtetërore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është titulli i ligjit. Duke parë përmbajtjen e ligjit shih edhe termat që janë përdorur. Mënyra e formulimit është një qasje e këtij ligji me atë “Për Policinë e Shtetit”, në të njëjtat standarde për këtë pikë.

Pjerin Ndreu – Unë e shoh në listë, sepse ju i jeni referuar, por për Policinë e Shtetit e keni kopjuar ligjin, sidomos te sistemi i gradave. Keni kopjuar pjesën më të keqe dhe më të paligjshme që ka ligji “Për Policinë e Shtetit”.

Spartak Braho - Zoti Ndreu, le të mbarojë specialisti përgjigjen e pyetjeve.

Artur Zoto - Në lidhje me shtesën që është bërë te pika 4 e nenit 8, që thotë se strukturat e këtij shërbimi janë pjesë e organikës ose strukturave të institucioneve penale në nivel, qëllimi i kësaj shtese ka qenë për të theksuar ose për të sqaruar strukturën hierarkike që ka ky lloj shërbimi. Ky lloj shërbimi shtrihet si në nivel qendror, ashtu edhe vendor. E pamë të domosdoshme ta bënim këtë shtesë, sepse pika 4 e nenit 8 bën strukturimin ose organizimin

hierarkik të këtij shërbimi. Ky ishte një problem i lindur dhe nga praktika e përditshme, për të rregulluar marrëdhëniet e drejtuesit të një institucioni të ekzekutimit të vendimit penal në nivel vendor me ato të shefit të strukturës së sigurisë. Kështu që, në këtë aspekt, mendoj se si formulimi, si qëllimi që kemi shtuar, janë të qartë: për të ruajtur përbërjen hierarkike.

Luan Rama - Në aspektin kuptimor është gabim, sepse nuk ka logjikë fjalia “Struktura e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve në nivelin e IEVP-së është pjesë e strukturës së çdo organike të IEVP-je”. I bie njësoj si të thuash që, për analogji, struktura e Drejtorisë së Policisë së Shtetit është pjesë e organikës së strukturës së çdo komisarati. E zeza mbi të bardhë. Pra, “Struktura e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve në nivelin e IEVP-së është pjesë e strukturës dhe e organikës së çdo IEVP-je”.

Artur Zoto - E kemi theksuar këtë, sepse IEVP-të në përbërje të tyre nuk kanë vetëm strukturën e policisë, por kanë edhe struktura të tjera, siç lidhen, për shembull, strukturat e shërbimit mjekësor, të shërbimit ligjor, të shërbimit edukativ dhe social, si dhe shërbimeve të logjistikës. Duke pasur parasysh që përbërja e IEVP-ve ka edhe struktura të tjera, e theksuam që është pjesë e organikës së kësaj strukture.

(Diskutim pa mikrofon.)

Flamur Noka - Mund të bëhej rregullimi i strukturave dhe jo i drejtorisë, sepse në momentin që ke thënë strukturave të Drejtorisë së Policisë së Burgjeve do të thotë që ti e ke kapur se kupola njësohet me bazën. Ti mund ta bësh kështu: “Struktura e Policisë së Burgjeve shkon në harmoni me të gjitha strukturat dhe organikën e IEVP-së”. Po jo e drejtorisë.

Ardian Turku - Për procedurë. Në fakt, jemi akoma të pjesa e pyetjeve. Po bëjmë diskutime nen për nen dhe për pjesë të caktuara të nenit, fjali të caktuara. Nuk kam ndonjë vërejtje për thelbin. Komisioni i Ligjeve mund të ketë parë dhe rregulluar shumë nga këto gjëra.

(Diskutim pa mikrofon.)

Nuk e kam mbaruar. Nëse është e mundur, vazhdojmë të operojmë me përgjigjet pa bërë debate. Kur të vijmë nen për nen, mund të bëhen rregullime. Nëse te Komisioni i Ligjeve, ku janë më profesionistë, kanë kaluar gjëra, të mos zgjatemi më.

Spartak Braho - Të kalojmë procedurat njëherë. Jemi dakord në parim me ligjin?

(Nga salla deputetët përgjigjen: po)

Ndoshta u tejkalua një çikë me ato pyetjet që bëri Luani, të cilat kishin të bënin kryesisht me përmbajtjen e dispozitave të veçanta.

Ermonela, mund të na thuash se çfarë pyetjesh janë bërë në Komisionin e Ligjeve nen për nen?

Ermonela Felaj - Nuk e kemi kaluar ligjin nen për nen. E kemi miratuar vetëm në parim. Një pjesë e vërejtjeve që dëgjova nga zoti Rama, në fakt janë ngritur edhe në Komisionin e Ligjeve, në diskutimin në parim.

Spartak Braho - Nuk e keni përfunduar?

Ermonela Felaj - Jo. Nuk e kemi kaluar nen për nen.

Flamur Noka - Ka edhe një çështje. Në momentin kur do të shkojë ligji në Komisionin e Ligjeve, për t'u diskutuar nen për nen, duhet të ketë kaluar edhe në Komisionin tonë. Pse? Duke qenë se Komisioni i Ligjeve është përgjegjës, nuk mund të bëjmë ndërhyrje pas tij. Është e nevojshme që ky ligj të përmirësohet dhe të kalojë i përshtatur me legjislacionin e BE-së, por ne duhet ta shqyrtojmë para se të shkojë në Komisionin e Ligjeve. Duhet të fillojmë shqyrtimin nen për nen. Kur të shkojë në Komisionin e Ligjeve, të jetë i shoqëruar me relacionin përkatës.

Spartak Braho - Në parim qemë dakord. Fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Ka vërejtje? Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Këtë nen duhet ta rregulloni në aspektin gjuhësor. Pika 4.

Xhemal Qefalia - Te neni 4, pika 3, për të evituar dhe problemet që u diskutuan, mendoj që të reduktohet, megjithëse është teknikë legjislative dhe do të shikohet edhe në Komisionin e Ligjeve: nuk ka nevojë që të shënohet në “nivel qendror”, por të thuhet shprehimisht: “Drejtoria e Policisë së Burgjeve është pjesë e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Policisë së Burgjeve miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit të Drejtësisë”. Pika 4 bie. Nuk ka nevojë të thuhet se ku qëndron policia në institucione. Kjo përmbush të gjithë boshllëkun dhe diskutimin paraprak.

Faleminderit!

Spartak Braho - Zoti Qefalia propozon që të hiqet fjala “në nivel qendror”. Jemi dakord? Jemi dakord.

Flamur Noka - Unë propozoj se zgjidhja më e mirë do të ishte që të hiqej vetëm termi “drejtorisë”, pastaj shkon shumë mirë në përshtatje me nivelin e organikës dhe strukturës. Pse? Ka një kontradiktë. “Struktura e drejtorisë së policisë në nivel IEVP-je është pjesë e strukturës së organikës së çdo IEVP-je”. Jo. Struktura organike e çdo IEVP-je është pjesë e drejtorisë së madhe të IEVP-së. Ashtu shkon dhe struktura e policisë. Struktura e policisë së çdo IEVP-je është pjesë e organikës së IEVP-së dhe shkon në pjesën totale përbërëse të Drejtorisë së Burgjeve, që quhet IEVP-ja.

Spartak Braho - Çfarë komenti ka?

Sokol Pasho - Mund të ketë një zgjidhje me një frazë të vetme. Te pika 4. “Shërbimi i Policisë së Burgjeve, në nivel IEVP-je, është pjesë e strukturës së organikës”. Shtohet togfjalëshi” Shërbimi i Policisë së Burgjeve” dhe e zgjidh situatën.

Spartak Braho - Dakord? Dakord.

Flamur Noka - Këtë thashë edhe unë. Hiqet fjala drejtori dhe rregullohet.

Spartak Braho - Po. Propozimi i zotit Noka miratohet.

Neni 6.

Flamur Noka - Me leje? Te neni 5 kisha një pyetje. “Shoqërimi i personave të burgosur që vuajnë dënimin në burgjet e sigurisë së ulët, nga kompania private e kontraktuar sipas legjislacionit në fuqi për prokurimet publike për shërbimet e transportit të të burgosurve nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve”. Me rregullore apo me akt nënligjor do të rregullohet mënyra se si kontraktohet, se si operohet me kompanitë private? Çfarë kriteresh duhet të plotësojnë këto kompani private? Apo do të jetë vendim qeverie?

Artur Zoto - E përmenda që aplikimi i këtij ligji do të pasohet me plotësimin apo hartimin e miratimin e një...

Spartak Braho - Të lutem! Zoti drejtor, mos i bjer larg e larg. Pyetja është direkte: si do të operojnë kompanitë private?

Artur Zoto - Do të operojnë në bazë të kriterëve të vendosura nga ana jonë dhe do t'i nënshtrihen ligjit të prokurimit.

Flamur Noka - Çfarë kriteresh keni përcaktuar, sepse kjo është shumë e rëndësishme?

Artur Zoto - Thashë në fillim, ligji duhet parë në tërësi. Pyetja e bërë nga zoti deputet e ka përgjigjen te neni 9, pika 5, ku thuhet: “Këto marrëdhënie do të rregullohen me VKM”. Është e qartë.

Ardian Turku - Do të rregullohet me akte nënligjore, sigurisht. A janë gati këto nënligjore?

Artur Zoto - Sigurisht që këto akte nënligjore aktualisht nuk i kemi gati, sepse presim që të miratohen ndryshimet, pastaj do të pasohet më ngritjen e grupeve të punës, të cilat do të bëjnë të mundur hartimin e tyre.

Spartak Braho - Pa komente.

Ardian Turku - Nuk kam komente, por kam të drejtën për të folur.

Spartak Braho - Komente bëj, por mos e zgjat kot. Ne t'i vëmë afat atij që brenda një muaji të miratojë aktet.

Ardian Turku - Më vjen keq, e di unë se çfarë them. Domethënë, dëgjojeni, se edhe unë kam të drejtën të flas. Problemi është që kemi, po e quaj, një precedent këtu në Kuvendin e Shqipërisë, në kuptimin që i kemi kaluar tamam kështu siç i keni sjellë ju projektligjet dhe i kemi bërë ligje duke lënë detyra për aktet nënligjore. Ka ndodhur një ndryshim në vjeshtën e vitit të kaluar, në këtë legjislaturë, me aktin normativ për statusin e nëpunësit civil. Meqenëse nuk ishin bërë aktet nënligjore, u rrëzua ajo që ishte bërë me shumicë të cilësuar. Domethënë, ky precedent i krijuar në Kuvendin e Shqipërisë nuk para lejon të miratojmë ne ligje e të themi që do të bëjmë akte nënligjore mbrapa. Për mua bëni si të doni. Unë desha ta përmend vetëm si precedent, se kështu e keni bërë ju si maxhorancë.

(Diskutime pa mikrofon.)

Spartak Braho - Ne do t'i vëmë afat. Të mos hyjmë në atë debat tani.

Neni 12.

Flamur Noka - Të mos hyjmë në atë debat.... Është debat politik, s'është debat juridik, se aktet këtu ishin 3 muaj pas datës 1 tetor. Se ligji i nëpunësit civil 3 muaj pas hyrjes në fuqi...

(Diskutime pa mikrofon.)

Spartak Braho - A ka probleme neni 6?

Piro Lutaj - Për nenin 6, që bën ndryshimet e nenit 12, do t'ju sugjeroj që germa "b" e pikës 2, ku thuhet "I rekomandon drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve marrjen e masave etj.," të mos lihet fjala "rekomandon", sepse duket si fakultative, por të përcaktohet duke thënë "i propozon".

Spartak Braho - Nuk ka ndonjë ndryshim.

Piro Lutaj - Jo, propozimi me shkrim është tjetër gjë. Rekomandimet ose i merr, ose jo.

Propozimi është akt.

Luan Rama - Kam unë një pyetje për pikën 1 të nenit 12. “Drejtori i Policisë së Burgjeve është autoriteti më i lartë administrativ”. Nuk krijon përplasje kjo me autoritetin e drejtorit të Përgjithshëm? Jo administrativ! Po i dhe autoritet administrativ, ai dublon drejtorin e Përgjithshëm. Drejtori i Policisë së Burgjeve është autoriteti më i lartë teknik dhe profesional i Policisë së Burgjeve, por jo administrativ. Autoriteti më i lartë administrativ në Drejtorinë e Burgjeve është drejtori i Përgjithshëm.

Artur Zoto - Mendoj se togfjalëshi në fund të fjalisë “i Policisë së Burgjeve” thekson faktin që është autoriteti më i lartë administrativ për këtë lloj strukture”. “Drejtori i Policisë” e bën mirë përkufizimin. Togfjalëshi “i Policisë së Burgjeve” ka lidhje me autoritetin më të lartë të Policisë së Burgjeve.

Luan Rama - Drejtori më i lartë administrativ i burgjeve dhe i Policisë së Burgjeve dhe i Policisë Civile në Burgje është drejtori i Përgjithshëm. Nuk mund të jetë autoriteti më i lartë administrativ një funksionar që dhe në gradë mund të jetë poshtë jush, ose i barabartë me drejtorin e Përgjithshëm, ose që është në varësinë e drejtorit të Përgjithshëm.

Artur Zoto - Duhet të kemi parasysh që drejtori i Përgjithshëm është funksion civil në krahasim me raportin ose marrëdhënien që ka me drejtorin e Policisë së Burgjeve. Jo pa qëllim e kemi cilësuar “autoriteti më i lartë administrativ”, që do të thotë edhe hierarkik, edhe kontrollues, edhe funksional i Policisë së Burgjeve. Mendoj se ky togfjalësh e bën më së miri përkufizimin dhe lidhjen.

Spartak Braho - A jeni dakord me nenin 6?

Luan Rama - Unë nuk jam dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Spartak Braho - Dakord. Shikojeni.

Neni 7.

Flamur Noka - Kam unë një problem për pikën 1 të nenit 7. “Rregullat dhe procedurat në marrëdhëniet e punës, trajnimit, ecurisë në karrierë dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës përcaktohen në rregulloren e personelit të miratuar me VKM”. Për sa kohë te neni 3 është administratë publike, duhet saktësuar në mos me statusin e nëpunësit civil, me Kod Punë apo me ligj, sepse nuk mund të varet fati i gjithë punonjësve të Drejtorisë së Burgjeve, të policisë etj., nga një VKM apo një person, që do të autorizohet nga vendimi i qeverisë.

Spartak Braho - A ka komente?

Artur Zoto - Zoti kryetar, mendoj se në vazhdim të këtij ligji është e nevojshme pasja e një rregulloreje të veçantë për personelin, që punon në strukturat e këtij lloj shërbimi. Jemi referua më së mirë përvojës së Policisë së Shtetit. Të njëjtën që ka edhe Policia e Shtetit: ka ligjin e Policisë së Shtetit, të miratuar në vitin 2007, por ka edhe rregullore.

Spartak Braho - Kot e bën krahasimin me Policinë e Shtetit.

Flamur Noka - Nuk është e njëjta gjë me ligjin e Policisë së Shtetit. Kjo e fundit ka një ligj organik.

Spartak Braho - Ky është merakuri që ngriti zoti Rama pak më parë.

Flamur Noka - Ajo që tha zoti Rama, pra Policia e Shtetit ka ligj organik dhe funksionon ndryshe. Policia e Burgjeve nuk ka ligj organik, sepse ky që diskutojmë sot nuk është ligj organik. Kështu, pika 1 e nenit 13 duhet të shikohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Rregullat dhe procedurat në marrëdhëniet e punës, trajnimet dhe ecuritë në karrierë duhet të përcaktohen ose me mbi bazën e ligjit të nëpunësit civil, që në këtë rast nuk vlen për Policinë e Burgjeve, ose mbi Kodin e Punës. Marrëdhëniet e punës nuk mund të caktohen me VKM. Mendoj se ky është gabim nga ju. Dikush tjetër mund ta rrëzojë, por unë mendoj se marrëdhëniet e punës nuk mund të bazohen mbi një VKM, ka ose ligj ose Kodin e Punës.

Spartak Braho - Fjalën e ka zoti Subashi.

Armando Subashi - Ne besojmë e kuptojmë që kur flasim për marrëdhëniet e punës, sigurisht që Kodi i Punës rregullon kornizat e përgjithshme të atyre marrëdhënieve, të drejtat dhe detyrimet bazë, që kanë punëdhënësi dhe punëmarrësi në raport me njëri-tjetrin. Kjo është një punë shumë specifike, e cila ka nevojë, nga ajo ç'ka parashikohet këtu, për shumë detaje të tjera, të cilat, për një punonjës të zakonshëm në një administratë tjetër, ndoshta nuk do të jenë të nevojshme për t'u parashikuar në një akt. Fjala vjen, që nga mënyra e veshjes, e sjelljes, e komunikimit me eprorët etj. Pra, Kodi i Punës nuk i ka të gjitha këto dhe nuk ka se si t'i ketë. Ndërsa, një akt i posaçëm duhet t'i përcaktojë këto si detaje. Për të hequr këtë merakun që ju keni, jam dakord që të shtojmë diçka këtu: "Të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit, në përputhje me Kodin e Punës". Kjo e mbyll historinë dhe kuptohet që VKM-ja nuk mund të dalë në kundërshtim me Kodin e Punës.

Flamur Noka - Unë nuk thashë të rrëzohet ky nen. Unë thashë që sanksionohet Kodi i Punës. Pra, të jetë në përputhje me Kodin e Punës.

Spartak Braho - Unë kam propozimin që të shtohet: "...si edhe legjislacioni në fuqi". Kështu mbyllet kjo çështje.

Urdhëroni, zoti Pjerin!

Pjerin Ndreu - Ligji për Policinë e Burgjeve, që të mos i ngatërrojmë gjërat, është një ndër tri ligjet bazë që normojnë të gjithë veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve: ligji "Për trajtimin e të burgosurve", ligji "Për Policinë e Burgjeve" dhe ligji "Për ekzekutimin e vendimeve penale" dhe trajtohet si ligj organik. Të mos i ngatërrojmë gjërat. Të ky ligj duhet të marrin zgjidhje të gjitha problemet edhe në kontekstin si i zgjidh ligji "Për Policinë e Shtetit". Vetë termi "polici burgjesh" na bën që të mos e ngatërrojmë me administratën civile, se i ka të përcaktuara edhe gradat. Vetë grada pastaj të fut në konjuktura të konkurrimeve, të cilat përcaktojnë pastaj se si do të kesh ecuri në karrierë. Ne nuk kemi pse t'i ngatërrojmë gjërat. Është një ndër tri ligjet bazë, që normon të gjithë punën e sistemit penitenciar të burgjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Cili është ligji tjetër që është në piketë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Flamur Noka - Çështjen nëse është ligj organik duhet të na e sqarojnë ata. E kanë formuluar dhe na e kanë sjellë si ligj organik, apo jo? Duhet të na e sqarojmë. Po që se është ligj organik, pastaj është tjetër gjë.

Ermonela Felaj - Unë dua të tërheq vëmendjen e të gjithëve. Pika 1 e nenit 13 është një fjali e pakuptimtë. Vërgjani veshin fjalisë dhe lexojeni: "Rregullat dhe procedurat për marrëdhëniet e punës (Vijon), trajnimit (Domethënë procedura për marrëdhëniet e trajnimit), ecurisë në karrierë dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës...". Është komplet e pakuptimtë nga pikëpamja gjuhësore. Duhet të riformulohet dhe të thuhet: "Marrëdhëniet e punës, trajnimi, karriera rregullohen në rregulloren e personelit", e cila, natyrisht, nuk mund të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, se nuk mundet që Këshilli i Ministrave të miratojë rregullore, është koncept tërësisht alogjik, por rregullorja mund të miratohet nga ministri i linjës. Është alogjike. Si mund të miratohet rregullorja me vendim të Këshillit të Ministrave? Është akt më i ulët, i cili nuk mund të miratohet me një akt më të lartë, ajo bazohet atje. Mund të miratohet nga

ministri po, por jo nga Këshilli i Ministrave. Si mbledhet Këshilli i Ministrave për të miratuar rregulloren? Nuk ka sens.

Spartak Braho - Të riformulohet nga ekspertët duke pasur parasysh vërejtjen e zonjës Ermonela. Pasi nuk miraton rregullore Këshilli i Ministrave.

Për nenin 8 ka vërejte?

Për Policinë e Burgjeve, është strukturë më vete Garda e Republikës

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Flamur Noka - Këshilli i Ministrave miraton rregullore, është tjetër gjë nëse duam t'ia lëmë si kompetencë ministrit të Drejtësisë hartimin dhe miratimin, por ministri i Drejtësisë e harton, e propozon dhe e miraton në Këshillin e Ministrave. Si praktikë egziston...

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Unë e kam në sensin që Këshilli i Ministrave miraton rregullore, pastaj unë nuk po flas për këtë rregullore. Mund të mos miratojë të Policisë së Burgjeve, por rregullore miraton.

Spartak Braho - Vazhdojmë me nenin 8.

Piro Lutaj - Atëherë neni 8 i projektligjit të paraqitur lidhet me ndryshimin e nenit 14 të ligjit ekzistues, i cili ka të bëjë me “kohën e punës e të pushimit”. Unë ia kam propozuar Komisionit të Ligjeve, jua propozova dhe juve, të nderuar, në fillim të mbledhjes. Unë kërkoj riformulimin e këtij neni, në bazë të vendimeve të qeverisë që kanë dalë, për “kohën e punës dhe pushimit të të gjithë administratës së shtetit shqiptar”. Përderisa themi se Policia e Burgjeve është pjesë e administratës, ne do ta trajtojmë atë në bazë të akteve që ka nxjerrë qeveria. Sigurisht ne nuk mund t'i referohemi këtu në mënyrë të posaçme këtij vendimi, por duhet të marrim pasazhe të këtij vendimi dhe t'i vendosim në ligj, për arsye se përmbajtja e ligjit për Policinë e Burgjeve, me vendimet që kanë dalë, ku trajtohet pjesa tjetër e administratës publike “për kohën e punës dhe pushimit”, nuk përputhet.

Spartak Braho - Ka ndonjë koment?

Piro Lutaj - Unë flas për të gjithë nenin 14 të ligjit ekzistues bazë, se ai ka bërë disa ndryshime dhe i ka përfshirë në nenin 8 të projektit. Unë mendoj të bëhet një riformulim tjetër, duke pasur parasysh të gjithë administratën.

Flamur Noka - Ka specifikë Policia e Burgjeve.

Piro Lutaj – Të vendosim specifika, por në bazë të vendimeve. Të mos vendosim specifika për t'i penalizuar, por për t'i lehtësuar.

Spartak Braho – Atëherë, sugjerimi i zotit Lutaj t'i shkojë Komisionit të Ligjeve për riformulim, apo rishikim, që të mos pengojmë punën.

Për nenin 9 ka vërejtje?

Për nenin 10 ka vërejtje?

Luan Rama - Më fal, te neni 9 kisha një pyetje. Te pika 2 thuhet: “paga mujore e punonjësit të Policisë së Burgjeve përbëhet nga paga bazë, që është paga për gradë dhe nga shtesat e tjera referuar kushteve të punës dhe të funksionit”.

Pyeta: po vjetërsia dhe kualifikimet përfshihen këtu, apo jo?

Mund të jetë Doktor i Shkencave. “Grada” është gradë policore, por unë po flas për grada ose tituj shkencorë apo akademik.

Xhemal Qefalia - Ku ka titull shkencor në polici?

Luan Rama - Drejtori i Policisë së Burgjeve mund të jetë dhe Doktor i Shkencave.

Spartak Braho – E zgjidh me ligj të posaçëm, ligji për gradat shkencore.

Luan Rama - Po vjetërsia si zgjidhet, zoti Xhemal?

Spartak Braho – E zgjidh ligji për sigurimet shoqërore.

Artur Zoto - Për pyetjen: A përfshihen kualifikimet dhe trajnimet? Po. Ligji përcakton se pagesa është e lidhur me gradën dhe funksionet janë të lidhura, sepse në Policinë e Burgjeve edhe pagesa është e lidhur me gradën, gjithashtu, karriera me gradën, me ecurinë e në lidhje me gradën, është lidhur tekstualisht me trajnimet dhe kualifikimet që ke.

Spartak Braho – Po vjetërsia?

Sokol Pasho - Vjetërsinë e ke referuar kushteve të punës apo funksionit përkatës. Funksioni përkatës ka të bëjë, për shembull, specialisti i regjimit të brendshëm mund të bëjë 10 vjet specialist i regjimit të brendshëm dhe merr vështirësi për atë pjesë. Për këtë pjesë kemi marrë dhe miratimin e Ministrisë së Financave.

Spartak Braho – Për nenin 10 ka vërejtje?

Piro Lutaj - Kam një problem. Neni 10, pika 3/2, ku thuhet: “kanë përparësi për pranimin në Policinë e Burgjeve shtetasit” e të tjera e të tjera, në fund, pas fjalës “kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë dhe Fakultet Juridik”, për arsye se e kemi ngushtuar shumë te ky militarizimi, te këto segmente, ose të kenë punuar në Gardë, në Policinë e Burgjeve, në Policinë e Shtetit ose në SHKB. Le ta zgjerojmë: “këta mund të jenë civilë”. Është goxha i konsiderueshëm nëse do të ishte një jurist për t'u angazhuar në këto struktura. T'i lëmë një

hapësirë. Pra, t'i japim përparësi në përparësitë që ju keni parashikuar. Le të kemi edhe persona me formim juridik, që të futen në strukturat e policisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Zoto - Nëse do të bëjmë atë shtesë, unë mendoj se ne do të prishim mënyrën e ecurisë në karrierë. Një nga qëllimet që kemi pasur kur kemi sjellë këto ndryshime është ruajtja e ecurisë në karrierë. Futja e asaj shtese që ka mbaruar ose dhënia prioritet e personave që mbarojnë do të na prishë tekstualisht ecurinë në karrierë dhe do të na krijojë mundësi abuzive. Për këtë qëllim, pse e kemi bërë për Forcat e Armatosura? Nisur nga ngjashmëria e shërbimit. Po të shikoni, te ndryshimet më poshtë, kemi thënë: “ekuivalentimi i gradës së këtyre do të bëhet me një ...”, në mënyrë që të ruhet karriera. Nuk duam ta prishim karrierën. Në mënyrë që të kemi të qarta procedurat e rekrutimit. Nëse, një me juridik do që t'i atashohet kësaj strukture, procedurat e rekrutimit dhe të ecurisë në karrierë janë shumë të qarta. Mendoj mos ta bëjmë këtë sepse do ta prishim.

Spartak Braho - Mirë atëherë, dakord me nenin 11? Nuk ka vërejtje.

Neni 12 ka vërejtje?

Nuk ka vërejtje.

Neni 17, trajnimi, dakord? Nuk ka vërejtje.

Neni 13 ? Dakord? Nuk ka vërejtje.

Neni 14 dakord? Nuk ka vërejtje.

Neni 14 që ndryshon nenin 19.

“Drejtor i Policisë së Burgjeve mund të emërohet personi që krahas kritereve të përgjithshme, sipas nenit 17 të ligjit, plotëson edhe këto kritere: të ketë arsim të lartë, të ketë shërbyer në Policinë e Burgjeve ose në Policinë e Shtetit për një periudhë të paktën 10 - vjeçare, ku në tre nga këto vite të ketë mbajtur gradë të rolit të lartë”.

Piro Lutaj - A mund të them diçka? Unë mendoj se te germa “a” e nenit 19 të mos kufizohet thjeshtë “të ketë arsim të lartë”, pasi mund t'i jepni një përparësi, ashtu siç iu referuat te pranimet, te prioritetet e personave që pranohen, t'i jepni përparësi dhe ta zgjeroni, sipas gjykimit tim, të thuhet: “të ketë arsim të lartë policor, ushtarak ose juridik”.

Unë i qëndroj kësaj për arsye se është një kontingjent njerëzish, të cilët vijnë nga formime juridike dhe të cilët angazhohen në strukturat e policisë. Edhe për argumentin që dhatë herën e parë, zoti drejtor, unë vazhdoj t'i qëndroj asaj ide. Unë nuk e kundërshtova, unë thashë të

njëjtën gjë edhe herën e parë. Ne marrim një person, i cili sapo ka përfunduar arsimin e lartë juridik. Ne nuk kemi sot një shkollë të lartë për Policinë e Burgjeve, as për Policinë e Shtetit. Atëherë, ky student që sapo ka mbaruar fakultetin juridik, kërkon të futet në strukturat e Policisë së Burgjeve. Pse duhet t’ia kufizojmë? Pra, në këtë sens duhet të qëndrojmë te germa “a” e nenit 19. Pra, ta zgjerojmë, të mos kufizohemi thjesht me arsim të lartë.

Spartak Braho - Dakord. Zoti Artur, ju keni një merak se e kemi diskutuar edhe herën tjetër këtë merakun tënd e zgjidh pika “b”. Lexoje me vëmendje pikën “b”. Ajo të mbyll.

Prandaj, edhe unë jam dakord me propozimin e bërë nga zoti Piro, që të ketë arsim të lartë ushtarak policor, juridik. Atë merakun që ke ti, e ke të zgjidhur nga pika “b”.

Xhemal Qefalia - Më fal, edhe diçka tjetër. Lidhur me vijueshmërinë, jam plotësisht dakord me këtë, vetëm se kjo pjesa e fundit ku thuhet: “3 vitet e fundit të ketë mbajtur gradën më të lartë”, duket gati sikur ne e individualizojmë këtë. Nuk ka pse të thuhet. Nuk ke pse t’i vësh “3 vitet e fundit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Xhemal Qefalia - “... ku në tri nga këto vitet të ketë”

Keltis Kruja - “...në tri nga këto vitet...”

Xhemal Qefalia - “...nga 10...”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Xhemal Qefalia - Dakord..

Spartak Braho - Urdhëroni, zoti Artur!

Artur Zoto - Zoti kryetar, merakun im në lidhje me shtesat që mund t’i bëjmë pikës “a” është: Në mënyrën që e kemi formuluar ne i kemi dhënë mundësitë, sepse unë kam parasysh ecurinë e karrierës në sistem në këtë lloj shërbimi, se për të punuar në këtë shërbim aplikojnë edhe persona, të cilët kanë jo vetëm arsimin juridik ose profesional, por kanë dhe arsimime të tjera. Në këtë mënyrë ne nuk e diskriminojmë këtë kategori personash që u lind e drejta të rriten në gradë. Është parimi universal për karrierën. Në këtë mënyrë ne e kemi lënë të hapur, dhe është më mirë kështu, mendoj unë.

Shkëlqim Selami - Më fal, kryetar, por te kjo pikë do të thosha edhe unë diçka më tepër, sepse po bëjmë shumë komente, por thelbi i Policisë së Burgjeve, për mendimin tim, duhet të ketë kritere të tjera që në marrjen e policëve që aplikojnë në të, të cilët duhet të kenë një moshë mesatare maksimale, për mendimin tim, deri në 35 vjeç. Duke qenë se individët që vijnë në

Policinë e Burgjeve kanë të bëjnë me një specifikë të veçantë, me probleme të ndryshme dhe me njerëz të dënuar me burgje të përjetshme, duhet të jenë të trajnuar edhe nga ana fizike edhe nga ana psikologjike, por edhe nga ana, që duhet parë në këtë ligj, e kurseve.

Në qoftë se ne nuk kemi një akademi të burgjeve, që është problem, absolutisht që duhet parë trajnimi ose bërja brenda strukturës së burgjeve e një strukture, ku të ketë mundësi për ata që aplikojnë dhe merren në Policinë e Burgjeve, të kryejnë një kurs të veçantë 6-mujor për Policinë Burgjeve, që ai të dijë si të sillet. Sepse ti e merr nga shkolla, e fut aty, dhe ai nuk e ka idenë se çfarë bën. Pra, meqenëse nuk kemi akademi burgjesh, ai që aplikon, e para, duhet të ketë një moshë maksimale deri në 35 vjeç, sepse në burgje mund të ketë dhe konfrontime fizike, të jenë të përgatitur fizikisht, psikologjikisht, të jenë të aftë, që të kalojnë dhe në një trajnim 6-mujor, ose dhe 3-mujor, që të rrisim cilësinë nëpër burgje. E dyta, mosha maksimale e daljes në pension të policëve të burgjeve duhet të jetë, për mendimin tim, 57 deri 58 vjeç, nuk duhet të jetë 65 vjeç. Sepse, çfarë mund të bëjë një polic 60-65 vjeç në një burg të sigurisë së lartë? Kështu që duhen parë edhe disa gjëra nga këto që të plotësojmë kuadrin dhe shërbimin brenda burgjeve.

Spartak Braho - Atëherë, dakord jeni me nenin 15? Dakord.

Dakord jeni me nenin 16? Dakord.

Dakord jeni me nenin 17? Dakord.

Dakord jeni me nenin 18? Dakord.

Jeni dakord me nenin 19?

Pjerin Ndreu - E para, te neni 17, te gradat. Atë që nisa ta them, po e them përsëri. Keni bërë ligje për Policinë e Shtetit dhe e keni implementuar fjalë për fjalë, të paktën në sistemin e gradave, e keni bërë gabim, sepse sistemi i gradave është i rregulluar në mënyrën më të keqe të mundshme. Këtu thuhet tekstualisht: “Grada e drejtorit të Policisë së Burgjeve merret me emërimin në detyrë të drejtorit të Policisë së Burgjeve dhe lihet me lirimin, me përjashtim nga detyra”. Ky është një handikap që e ka dhe ligji “Për Policinë e Shtetit”. Nuk ka sistem, as praktikë në botë, në sistemin e gradave, ku funksioni përcakton gradën. Në teorinë e gradave, në sistemet e gjithë botës, grada përcakton funksionin dhe jo funksioni gradën. Termi që “merr funksion” dhe “merr gradë” është shkelje flagrante e konceptit të gradave të ligjit “Për gradat” të të gjithë praktikave botërore. Kjo është shpikje “alla shqiptare”, dhe ju duhet të gjeni një model tjetër. Aq më keq tjetra, që “me dëshirën e tij dikush ulet në gradë”. Nuk ka ulje në gradë. Grada është personale, e gjithkujt. Grada merret, nuk dhurohet. Një person që e merr gradën e merr atë

për shkak të shkollimit, për shkak të vjetërsisë në punë, për shkak të kualifikimeve, për shkak të botimeve apo eksperiencës që ka në botën akademike. Grada është personale. Grada kurrë nuk mund të ulet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vetëm vendimi i gjykatës, nëse e merr si dënim plotësues.

Kështu që në këtë kontekst, të paktën mos e bëni edhe ju të njëjtin gabim. Ulja në gradë, një, dhe marrja e gradës së drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe lënia për shkak të funksionit, është gabim i papranueshëm. Duhet të gjeni një model gradash, jo të kopjoni. Edhe ligji “Për Policinë e Shtetit” e ka gabim dhe e ka futur në kolaps sistemin e gradave sot, për shkak të këtyre gafave. Unë që atëherë kam debatuar me teknikienë, të cilët i kam kolegë të mi dhe u kam thënë: “Ku e keni marrë këtë model? Kujt ia keni kopjuar këtë model?” Më kanë thënë “Jo, është shpikja jonë”. Nuk ka “shpikja jonë”. Grada merret, nuk dhurohet. Grada nuk mund të hiqet dhe as nuk mund të lihet.

Sistemi i gradave është piramidë. Të mos harrojmë një gjë: këtu fillojnë 2 mijë vetë, por ama në piramidë njëri shkon. Duke qenë se është sistem piramidë, në rrugë e sipër, për shkak të vlerësimeve, për shkak të pamundësisë për të kryer detyra funksionale, shumë vetë dalin në reformë dhe ikin. Është sistem i njohur ky, por gradën e mban gjithë jetën. Grada është personale. Në qoftë se unë e marr gradën “Kryekomisar”, askush nuk ka të drejtë të ma heqë, dhe unë quhem “Kryekomisar”.

Ky koncept që është banalizuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”, duhet të rregullohet në ligjin tuaj dhe ju duhet të gjeni një modul tjetër për të dalë me grada dhe jo të bëni të njëjtin gabim. Edhe në ligjin “Për Policinë e Shtetit” do të marrim iniciativë ligjore, nëse nuk e sjell Ministria e Brendshme, që të ndryshohet menjëherë. Është gafë fatale. Të kondicionosh gradën për funksionin, është gabim. Funksioni sjell gradën, jo grada funksionin. Ky parim dëgjohet vetëm në Shqipëri.

Spartak Braho - Dakord.

Urdhëroni, zoti Arben, dhe pa përsëritur atë tjetrin!

Arben Çuko - Unë jam plotësisht dakord me parafolësin. Gjithë ky bllok i këtyre neneve për gradat, unë mendoj se duhet të mbyllet vetëm me një, që gradat në Policinë e Burgjeve të dalin me ligj të veçantë, sepse ka aq shumë për të rregulluar, pasi po the gradë, nënkupton edhe karrierë. Kështu që propozimi im është që çështja e karrierës dhe e gradave në Policinë e

Burgjeve të dalë me ligj të veçantë, siç është në çdo institucion, siç është në Forcat të Armatosura, siç është në Policinë e Shtetit, siç është në Gardën e Republikës.

Pjerin Ndreu - Beni ka të drejtë, por mund të rregullohet.

Kapitulli i gradave mund të gjejë rregullim. Shikojeni mirë, konsultojeni mirë! Mund të gjejë rregullim edhe brenda këtij ligji. Këtu nuk ka asgjë të keqe. Kur ka qenë Piro, për shembull, ka qenë gjeneral atje, drejtor i Policisë së Burgjeve, dhe Piro është gjeneral, nuk i hiqet ajo gradë, nuk ia heq dot njeri. Dhe drejtori i Policisë së Burgjeve gjeneral ikën nga sistemi i burgjeve, mund të punojë kudo tjetër, dhe nuk mund të ulet më në kryekomisar ose në drejtues të parë. Nuk ka sens kjo punë.

Prandaj duhet ta rregulloni, sepse ky lloj sistemi duke u kthyer mbrapa në gradë me dëshirën e tij, bllokon edhe karrierën.

Spartak Braho – Dakord. Parimisht është e drejtë.

Keni ndonjë koment, Artur?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ja, Arben, të bëjë një koment ai.

Artur Zoto – Zoti kryetar,

Në lidhje me njehsimin e gradës me funksionin është parim universal në aspektin e policimit, por edhe po t'u referohesh eksperiencave më të mira, e kanë të njësuar gradën me funksionin. Pse e kanë bërë këtë aspekt? Është bërë njësimi gradë-funksion për të nxitur konkurrimin, e para, dhe për të qartësuar procedurat e fitimit dhe të marrjes së gradave.

Spartak Braho - Këtë po thonë edhe këta.

Artur Zoto - Po, por kjo nuk duhet njësuar, tha zoti Pjerin, nuk duhet njësuar grada me funksionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pjerin Ndreu - Grada sjell funksionin, njësohet, por funksioni vjen pas gradës dhe nuk vjen para gradës. Ju lutem, mos e ngatërmoni këtë gjë! E kanë edhe italianët Por kur kanë shkruar te niveli: drejtor dhe zëvendësdrejtor i Përgjithshëm, i kanë dhënë një gradë të tipit: doktor, prefekt, ndërsa ne nuk i kemi dhënë asgjë. I kemi dhënë vetëm emrin e funksionit. Kjo është një histori që nuk dëgjohet askund. Është shpikje “alla shqiptarçe” dhe ju nuk keni pse e merrni atë gafë të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe ta adaptoni. Drejtori i Policisë së Burgjeve duhet të ketë një gradë, se si e emërtoni ju gradën, gjejini në ligj! Por nuk ekziston parimi që merret grada kur

je drejtor i Policisë së Burgjeve dhe lihet grada kur nuk je më drejtor. Njësohet, por paraprin gradën. Ajo e sjell funksionin dhe jo funksioni gradën. Që të sjellë funksioni gradën, kjo është e papranueshme në çdo lloj parimi të gradave dhe këtë gabim e ka ligji “Për Policinë e Shtetit”.

Spartak Braho - Jemi dakord që kjo dispozitë të rregullohet sipas rekomandimeve dhe sugjerimeve që dhanë kolegët? Dakord. Mendojeni dhe ju, sepse mua më duket plotësisht e logjikshme! Diskutojeni edhe në Komisionin e Ligjeve. Neni 18? Dakord. Neni 19.

Luan Rama - Është çështje e vjetërsisë. Neni 19, pika pesë, thotë: “Pika 8 ndryshohet. Në vjetërinë për efekt grade llogaritet koha gjatë së cilës ai ka kryer shërbim aktiv në strukturat e policisë së burgjeve.” Po periudha që ka kryer në Policinë e Shtetit apo në Forcat e Armatosura llogaritet?

Artur Zoto - E kemi thënë ekuivalentimin e gradave. Kur të vijë ai nga Policia e Shtetit te Policia e Burgjeve do t’i bëhet ekuivalentimi i gradës. Më pas, ecuria nga karriera do të fillojë nga ky moment.

Spartak Braho - Me 20-n, dakord? Me 21-shin, dakord? Me nenin 22?

Pjerin Ndreu - Te neni 22 është i njëjti problem. Duhet futur në paketën e rregullimit. Nuk ka ulje në gradë. Duhet të hiqet ky koncept.

Arben Çuko - Ulja në gradë vjen vetëm si rezultat i masës disiplinore.

Pjerin Ndreu - Është masë e përkohshme. Mund të jepet deri në një vit. Nuk mund të jepet taksative ulja në gradë. Deri në një limit të caktuar.

(Diskutime jashtë mikrofonit.)

Luan Rama - Më falni! Pjerini thotë një gjë që në thelb është parimore. Ulja në gradë është një masë e përkohshme, e rregulluar edhe ajo në ligjin “Për gradat” sepse nëse do të aplikojmë këtë parimin që thoni ju këtu dhe nga “komisar” shkojmë “nënkomisar” për të ruajtur vendin e punës, prishim sistemin e karrierës dhe krijojmë një fenomen tampon që nuk të lejon më funksionimin e sistemit piramidal të hierarkisë dhe të karrierës. Nëse ai është “komisar”, do të rrijë në atë vend pune 5 vjet. Nëse nuk bëhet dot kryekomisar del jashtë sistemit, por nuk mund të bëhet më poshtë për të ndenjur në një vend që nuk i takon më atij. Del jashtë sistemit. Prandaj, parimi i gradës dhe i karrierës është universal. Duhet të orientohemi nga modelet që kanë edhe homologët tanë.

Meqë e mora fjalën, zoti kryetar, ne civilët duhet t’i dëgjojmë këta që vijnë nga fusha dhe që kanë bërë karrierë me gradat. Ne që kemi punuar me këta kemi më pak të drejtë se këta, por

kemi edhe ne një përvojë, dhe s'mund të improvizojmë me vesh. Sistemi i gradave është unik. Karriera me gradën është unik në çdo vend të botës që e aplikon. Sistemi i degradimit është sistem maoist apo komunist, apo si të doni quheni. Drejtori i Policisë së Shtetit është funksion dhe nuk është gradë. Italia e ka “prefekt” gradën më të lartë në hierarkinë e policisë. Merreni nga sistemi penitenciar i policisë së një vendi të BE-së dhe silleni në sistemin e gradave! E para. E dyta, ndoshta është ky sugjerim më me vend për Sokolin dhe për të gjithë Ministrinë e Drejtësisë, duhet parë me seriozitet përgatitja e një ligji tërësor për sistemin penitenciar në Shqipëri, ku të përfshihet një ligj organik për gjithë sistemin e burgjeve në Shqipëri, për të unifikuar gjithçka lidhet me këtë strukturë shumë të rëndësishme.

Faleminderit!

Spartak Braho - Kalojmë të neni 23. Dakord. Neni 24? Dakord? Neni 25?

Unë propozoj një shtesë para nenit 26, që aktet nënligjore të përgatiten brenda 3 muajve.

Arben Çuko - Gjatë vëzhgimit të këtij projektligji nuk vura re dy gjëra. E para, marrëdhëniet e disiplinës. Është parashikuar ndokund disiplina në burgje?

Mund të shtohet një nen këtu, se disiplina në Policinë e Burgjeve rregullohet në bazë të rregullores së hartuar nga ministri. E para, kjo. E dyta. Nuk pashë gjëkundi mënyrën e hapjes dhe përdorimit të armëve të zjarrit nga Policia e Burgjeve.

Spartak Braho - Na ktheve në fillim, o Arben!

Flamur Noka - Ky nuk është ligj i ri. Ky është përmirësim.

Spartak Braho - Faleminderit dhe punë të mbarë!

Brenda tre muajve nga paraqitja në Fletoren Zyrtare do të kontrollohen aktet në mënyrë të posaçme nga Komisioni i Sigurisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 06.03.2014, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Spartak Braho – kryetar i Komisionit

Projektligji “Për dhënie amnistie”.

Marrin pjesë:

Spartak Braho, Piro Lutaj, Arben Çuko, Armando Prenga, Paulin Sterkaj, Shkëlqim Selami, Pjerin Ndreu, Xhemal Qefalia, Taulant Balla, Luan Rama, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Armando Subashi, Ardian Turku, Flamur Noka, Alban Zeneli, Aqif Rakipi, Ylli Shehu, Astrit Patozi, Keltis Kruja dhe Helidon Bushati.

Mungojnë:

Mesila Doda dhe Arben Ristani.

Të ftuar:

Edlira Krypa - drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

Argita Alikaj - shefe e Sektorit të Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Artur Zoto - drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

Sokol Pasho – drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit Strategjik dhe Inspektimit të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Spartak Braho - Kalojmë në ligjin e dytë “Për amnistinë”.

Relator zoti Subashi.

Armando Subashi – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne e diskutuam në parim seancën e kaluar ligjin e amnistisë në Komisionin e Ligjeve dhe nga ky diskutim dolën një sërë sugjerimesh nga kolegët e Komisionit të Ligjeve. Përgjithësisht vërejtjet konsistojnë në faktin se ky ligj duhet të zgjerohet edhe pak. Në radhë të parë, ligji “Për amnistinë” prek jo vetëm personat e dënuara, por ndjekjen penale, pra, me fjalë të tjera, personat që janë në hetim dhe gjykim për një kategori veprash të caktuara dhe sigurisht që duhet të zgjerohet edhe pak efekti i ligjit të amnistisë në raport me personat e dënuar. Mbi këto propozime që u bënë në parim nga kolegët, duke pasur parasysh të ruhet edhe parimi i proporcionalitetit në kategoritë e ndryshme të të dënuarve apo të atyre që janë duke u proceduar, u bënë edhe ndryshimet e nevojshme në Komisionin e Ligjeve. Duke pasur parasysh që te neni 3 u bashkua pika “b” dhe “c” në pikën “a”, e cila i thithi ato çka kishin parashikuar pikat “b” dhe “c”. Afati kohor u la 31 dhjetori, sepse më 26 dhjetor drafti është miratuar në qeveri nga Këshilli i Ministrave dhe rreth kësaj date u gjykua të jetë edhe afati për këtë problem.

Sa u përket të dënuarave gra, me propozimin e kolegëve në Komisionin e Ligjeve u ul mosha dhe u parashikua mosha 50 vjeç. Për sa u përket të dënuarve burra dhe të miturve nuk kishte ndonjë ndryshim. Ajo çka është pozitive dhe shkoi në frymën e zgjerimit të amnistisë ose është pika 2 që propozuam atje, personat të cilët nuk përfitojnë nga ligji i amnistisë, për shkak të ndalimeve që ka neni 4, që vjen më poshtë, pra, të gjithë personave të dënuar, u falet një vit e gjysmë dënimi për gratë dhe një vit për burrat. Pra, nga dënimi që kanë marrë u falet një vit e gjysmë grave dhe një vit burrave. Pra, në qoftë se nuk përfitojnë nga pikat e tjera të ligjit, përfitojnë nga kjo pikë. Ndërkohë u shtua një pikë që amnistion ndjekjen penale. Pra, të gjithë personat që janë në hetim dhe gjykim, dhe ku vepra për të cilën akuzohen, parashikon një dënim deri në dy vjet maksimumi, i kap amnistia dhe çështja do të pushohet nga prokuroritë ose nga gjykatat, sipas fazës në të cilën ndodhet. Nëse ndodhet në hetim nga prokuroria, nëse ndodhet në gjykim nga gjykatat. Këto janë pak a shumë ndryshimet që u bënë në këtë pikë.

U shtuan edhe disa nene në fund. Për shembull, neni 6, që ka të bëjë me të drejtat civile të personave të tretë. Pavarësisht se si shkon fati i çështjes penale, sigurisht që të drejtat civile nuk

u hiqen të dëmtuarve ose personave të tretë dhe proceset civile mund të vazhdojnë nëpër gjykata. U parashikua dhe një dispozitë tjetër që në zbatim të këtij ligji ngarkohen prokuroritë, gjykatat, ministri i Drejtësisë, për të ndjekur dhe për të zbatuar ligjin “Për amnistinë”.

Spartak Braho - *(I drejtohet një deputeti.)* Ne nuk na duhet fare se çfarë kanë parë ata. Këto janë propozime të Subashit këtu, në Komisionin e Sigurisë, i miratojmë dhe pastaj ua çojmë atyre.

Helidon Bushati - I nderuar zoti kryetar,

Unë do të filloja me një konstatim. Tek aplikimi i amnistisë gjatë relacionit ka një formulë, nuk është parë vetëm si një akt mëshire, por dhe si një akt për të rivendosur legjitimitetin kushtetues në vendet e vuajtjes së dënimit ku ai është shkelur në mënyrë sistematike. Mua më duket një përcaktim shumë politik, sepse nuk ka të dhëna objektive, përkundrazi, nga organizmat që mbikëqyrin të drejtat e njeriut në burgje, del se atje ka pasur një përmirësim të dukshëm. Është te relacioni, te faqja 2, e shkruar tekstualisht: “Në vendet e vuajtjes së dënimit ku ai është shkelur në mënyrë sistematike”. Duket se keni kaluar kompetencat tuaja. Ky ishte konstatimi i parë.

Mbi çfarë kriteri objektiv është bazuar kërkesa për këtë amnisti, duke pasur parasysh dy gjëra, që amnistia paraardhëse është shumë e afërt, viti 2012 dhe tjetra, nuk përkon me një eveniment kombëtar, përvjetor pavarësie ose diçka e tillë? Gjovalin, aty ku ishe specialist, te burgjet, të lashë të flisje. Domethënë nuk përkon me një eveniment kombëtar.

(diskutime pa mikrofon)

A t’i bëj pyetjet një herë unë, pastaj bëni çfarë të doni. Po për çështjet nga ana teknike? Neni 2 ose 3: “Përfitojnë ata që kanë marrë një vendim të formës së prerë”. Po për çështjet ose të dënuarit që janë në shkallën e apelit?

Te neni 3, zoti Subashi tha se ka pasur një unifikim në pikën 2, të pikës “b” dhe “c”, duke rritur tavanin e faljes, domethënë duke e çuar tavanin për të gjithë në 3 vjet. Më parë ka qenë 2 vjet dhe vetëm pika “c” e nenit 3 e kishte 3 vjet për kohën e mbetur. Domethënë tani e keni çuar në 3 vjet. Në dijeninë time deri tani amnistitë kanë qenë deri në dy vjet, mund dhe të gabo, por ju mund ta hidhni poshtë këtë gjë. Pse është rritur tavani në 3 vjet?

Sokol Pasho - E para ka mbipopullim në burgje. E dyta, ka kosto sa të duash, se ne nuk se jemi një shtet i pasur.

Helidon Bushati - Nga ana e objektive, cili ka qenë argumentimi i rritjes së numrit të neneve të Kodit Penal që janë futur, mund të jenë 11, 12 ose diçka më tepër, efektet buxhetore, domethënë numri i përfituesve, meqenëse është një pyetje që do ta bëjnë më vonë? Ndoshta me këto 5 pyetje mendoj ta mbyllim.

Spartak Braho - Dakord. Po, përgjigjuni.

Sokol Pasho - Zoti kryetar,

Për të ndarë pjesën e pyetjeve që ka lidhje me relacionin, nga pjesa që ka lidhje me ligjin, me teknikalitetet ose me statistikën. Relacioni sigurisht që fokusohet në qëllimet që kërkohet të arrihen nëpërmjet këtij ligji dhe në fjalën e tij ministri përpara Komisionit të Ligjeve deklaroi që arsyeja pse bëhet kjo amnisti nuk është vetëm statistika, nuk është vetëm mbipopullimi, por dhe e lidhim këtë rast, apo miratimin e këtij ligji edhe me rekomandimet që ministri i Drejtësisë në emër të Këshillit të Ministrave do t'i paraqesë prokurorit të Përgjithshëm sipas ligjit, nenit 54 të ligjit "Për prokurorinë". Ministri i Drejtësisë autorizohet të bëjë këtë gjë deri në 31 mars të çdo viti dhe për këtë ministri do t'i kërkojë prokurorit të Përgjithshëm, në emër të qeverisë shqiptare, që, në përputhje me vullnetin e qeverisë shqiptare politika e dënimit nga ana e prokurorisë të orientohet në dy drejtime:

Në zbutjen dhe në përdorimin e alternativave dhe dënimet me burgim për veprat penale që parashikojnë dënimet deri në 5 vjet ose për dënime deri në 5 vjet dhe në ashpërsimin e dënimit për veprat penale që parashikojnë dënime mbi 5 vjet ose për dënime mbi 5 vjet. Në këtë kuptim kjo amnisti nuk vjen vetëm si një domosdoshmëri ose si një nevojë që lidhet me statistikën, me burgjet ose me mbipopullimin, por edhe me një orientim politik të qartë të qeverisë për të ndjekur këtë politikë penale dhe për të orientuar prokurorinë në këtë drejtim.

Si rregull, është e vërtetë që, historikisht, amnistia përkon me një datë, në një jubile, ose me një eveniment i çfarëdolloji qoftë, por kjo nuk është një gjë që ka lidhje me ligjin dhe nuk është një kërkesë ligjore. Pra, nuk ka kurrkund një parashikim ligjor që do të duhet të jetë e lidhur domosdoshmërisht me një datë ose me një event të caktuar, që do të thotë se nga momenti që nuk është një kërkesë ligjore, është e pamundur ta gjesh këtë gjë në ligj dhe kjo është arsye ekstraligjore.

Pse ka më shumë nene se sa amnistia e shkuar? Në fakt nuk ka më shumë nene nga amnistia e shkuar, por ka një fakt: ndërkohë që legjislacioni penal, përkatësisht Kodi Penal, ka evoluar dhe në këto 3 vjetët e fundit ka pasur disa ndryshime, që do të thotë se automatikisht janë

shtuar nene në Kodin Penal, pra, duke qenë një proces dinamik, sigurisht që kjo pasqyrohet edhe në ligjin “Për amnistinë”, sepse kjo është një zgjedhje shumë delikate midis veprave penale që përjashtohen dhe atyre që nuk përjashtohen. Për të qenë korrekt duhet të themi se amnistia e fundit ka qenë restriktive dhe kjo është po aq restriktive në përjashtimet e nenit 4, sa ka qenë amnistia e fundit ka qenë restriktive dhe kjo është po aq restriktive sa ajo që është e bërë 2 vjet më parë, në vitin 2012. Këto janë pak a shumë ato që mund të themi në lidhje me pyetjet.

Spartak Braho - Faleminderit! Urdhëroni!

Helidon Bushati - Pyetjet për rastet kur është në apel. Pyetja tjetër ishte

Faleminderit!

Sokol Pasho - Dakord! Atëherë, po ta shikoni me vëmendje, në formulimet për të cilat u ra dakord konsensualisht në Komisionin e Ligjeve, ruhet shprehja që përdoret edhe në Kodin e Procedurës Penale; bëhet fjalë për nenin 294 të Procedurës Penale, në mos gabohem, që flet për rastet e pushimit, një prej të cilave është edhe amnistia. Formulimi që do të gjenim në këtë projekt është në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit. Kur thuhet në çdo gjendje dhe shkallë të procedimit, përmbledh hetimin, gjykimin, derisa vendimi të ketë marrë formë të prerë ose jo. Për pjesën e kostove, sigurisht që është e qartë se çdo i burgosur apo i paraburgosur ka një kostim, dhe është një kosto e konsiderueshme për çdo buxhet të cilitdo shteti. Në këtë kuptim, përdorimi i formave alternative të dënimit me burgim, apo përdorimi i benefiteve që vijnë nga amnistia, sigurisht që nga pikëpamja buxhetore është e leverdishme për çdo qeveri dhe për çdo financë të cilitdo shtet. Përafërsisht përlllogaritet që kostoja e një të dënuari, që do të përjashtohet nga vuajtja e dënimit, dhe kalon (nuk jemi në këtë rast), në shërbimet e shërbimit të provës, është e përgjysmuar. Në këtë rast garantohet një kosto jo e përgjysmuar, por e shmangur, sepse në këtë rast...

(Diskutime pa mikrofon)

Atëherë, e thënë ndryshe, në çdo ligj është e drejtë të kërkohet se sa është kostoja e këtij ligji. Në këtë rast nuk kemi kosto...

(Diskutime pa mikrofon)

Spartak Braho – Nuk llogaritet tani.

(Diskutime pa mikrofon)

Urdhëroni, Aqif!

Aqif Rakipi - Do të flas shkurt. Nuk është se kam ndonjë gjë. Jam shumë dakord me zotin Subashi, për atë që tha. Edhe koalicioni ynë ka qenë dakord për faljen. Edhe ne e kemi diskutuar dhe kemi qenë pro. Për mendimin tim, nëse këta e kanë bërë dy deri në tre vjet, unë them katër deri në pesë. Ky është mendimi im. Pse?

E para, njëherë, ka një popullim shumë të madh nëpër burgje.

E dyta, ne nuk është se jemi ndonjë shtet shumë i pasur. Do të thoni ju, meqenëse nuk jemi të pasur le t'i nxjerrim të gjithë njerëzit nga burgjet. Jo, nuk jam për atë, por të gjithë po bëjnë falje si, për shembull, Italia, por edhe shumë shtete të tjera. Pse të mos bëjmë falje edhe ne? Mendoni pak se sa e ka koston një i burgosur këtu te ne. Kështu që, unë jam i mendimit që kjo të shikohet. Pse? Edhe për problemet që Shqipëria ka me Italinë. Ne jemi këtu të gjithë, e siç jemi bashkë, kemi numrat e telefonit të gjithë. Në Shqipëri njerëzit janë të lidhur shumë me njëri-tjetrin, aq sa duke u bazuar te kjo mund të qëllojmë të jemi tanët të gjithë këtu, po t'i futemi me themel. Sepse, siç flet një njeri që ka probleme, edhe unë që jam deputet mund të flas me Italinë, sepse pak a shumë unë këtu jam i zgjedhur drejtpërdrejt nga populli. sepse nuk jam me partitë e mëdha, por me parti të vogël. Këto janë ankesat që kanë njerëzit. Për shembull një njeri në Itali, që ka probleme atje, dhe ky vetë dënohet. Ka plot njerëz që janë këtu nëpër burgje, që kanë marrë dënim kot. Kështu që është shumë mirë që kjo të shikohet. Dhe meqenëse nuk po shikohet nga shteti, që, si të themi, ta ngrejë zërin në drejtim të Italisë, të paktën i jep një të drejtë duke e liruar këtu, sot. Kaq kisha. Unë jam krejtësisht dakord, por do të doja të shikohej edhe kjo: nga katër deri në pesë vjet, në qoftë se ka mundësi.

Spartak Braho - Dakord!

Luan Rama - Kam një propozim, zoti kryetar. Propozimin e kam më shumë në formë sugjerimi për zotin Subashi dhe për Sokolin, që të shikohet mundësia (në vlerësimin tim nuk ka asnjë problem) që çdo person i cili vuan dënimin, pavarësisht veprës penale për të cilën është dënuar, përjashtoj ato që me vendim gjykate janë të paapelueshme, i ka mbetur për të vuajtur një masë dënimi deri në një vit, të jetë pjesë e amnistisë.

Spartak Braho - E ka.

Luan Rama - Për çdo vepër penale?

(Diskutime pa mikrofon)

Por ka kufizime. Tani unë e kam lexuar.

Spartak Braho - Kufizim vetëm ai është, vetëm për nenin 4.

Paulin Sterkaj - Do ta kisha pyetur kolegun dhe bashkëqytetarin tim: A je për amnistinë, apo nuk je?

Atëherë, unë kam një ide. E mbështes deputetin parafolës. E mbështes jo për të rritur masën e amnistisë, por sepse ka shumë krime që sot nuk ekzistojnë. Nëpërmjet dënimeve që kanë marrë ata që vuajnë nëpër burgje, figurat e krimit janë asimiluar. Është punuar mirë, është goditur figura e krimit, dhe sot nuk ka më dënime për ato figura krimi. Kështu që, në momentin kur figura e krimit nuk është më vazhde e rasteve që ndodhin, natyrshëm duhet t'i amnistojmë. Sepse shpeshherë, në Kodin Penal janë ca nene, që siç e tha edhe Aqifi, ndodh me Italinë, por edhe me Shqipërinë, që merr një dënim shumë të madh. Ne, si parlament, në mënyrë të natyrshme duhet të shohim diçka tjetër. Pasi të kalojë amnistia, duhet të shohim mundësinë për të bërë një amendim të Kodit Penal, sepse i bie të dënohen me një masë jashtëzakonisht të madhe, kur ne e marrim këtë ligj nga eksperiencia e filan shteti. Në këtë rast, së paku armëmbajtjen pa leje e shoh si dënim shumë ekstrem, gjë që e kam thënë edhe herë të tjera. Armëmbajtja pa leje nuk dënohet askund në Europë, siç dënohet në Shqipëri. Duhet të kishte forma të tjera më të buta, por, kohët e fundit, armëmbajtja pa leje dënohet minimalisht shtatë vjet. Ai person që dënohet shtatë vjet, mund të ketë qenë viktimë e një presioni ose e ndonjë individi për ndonjë konflikt të vogël dhe për të mbrojtur jetën e tij, ai merr armën. Por në këtë rast ai nuk është kriminel. Dhe realisht, këto nene që ka amnistia i ka parashikuar edhe Komisioni i Ligjeve, me qëllim që amnistia të funksionojë te veprat penale që janë të amnistueshme. Kjo, nisur edhe nga fakti se në çdo shtet europian, herë pas here lind nevoja për amnisti. Kështu që, desha një përgjigje për pyetjen që të bëra në fillim: e ke qejf amnistinë, apo s'e ke qejf? Sepse kjo është bërë me mirëkuptim. Po nuk pati konsensus, amnistia nuk funksionon.

(Diskutime pa mikrofon)

Por ka edhe një gjë: në Shqipëri nuk funksionojnë...

Helidon Bushati - Ambistia nuk është rregull. Është përjashtim nga rregulli.

Spartak Braho - Ta mbyllem këtë debat.

Paulin Sterkaj - Në Shqipëri nuk funksionojnë shumë këto dënime alternative, siç i ka gjithë bota. Ne mendojmë se e rregullojmë punën duke e çuar tjetrin në burg. Ne ndoshta e prishim punën duke çuar njerëz në burg. Ka forma e mënyra të ndryshme për të pasur dënime alternative, nuk ka dënime alternative. Nuk funksionojnë në Shqipëri. Ju e dini sistemin dhe funksionimin e gjykatave në Shqipëri. Dhe do të bëjmë amnisti ne! Do vëmë dorë për të bërë

amnisti! Kështu që, përderisa nuk funksionon dënimi alternativ, amnistia është ajo që i rregullon këto marrëdhënie.

Spartak Braho - Dakord!

Nuk jemi mbledhur për ato sot, por për amnistinë. A jeni dakord, apo jo? Dëgjojmë edhe Ulsiun dhe e mbyllim.

Ulsi Manja - Në vazhdim edhe të asaj që tha Luani, meqenëse te Komisioni i Ligjeve, na ka shpëtuar, unë gjykoj se pika 2 e nenit 3, ku thuhet: “të gjithë personat e dënuar...”, unë propozoj të kalojë nen më vete pas nenit 4, sepse qëndron krejtësisht si nen më vete. Pra, në nenin 4 janë kriteret për ndalimin e amnistisë, por pika 2 e nenit 3, janë kriteret e përfitimit, thotë: “Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga sa më sipër, u amnistohet një vit e gjysmë”, e lamë atje “për burrat, dhe një vit për gratë”

Spartak Braho - Dakord!

Dakord.

Ulsi Manja - Do të kaloj si nen më vete.

Spartak Braho – Dakord.

Kush është dakord me propozimin e Aqifit, që të bëhet nga tre deri në katër? Nuk fiton.

Atëherë, jemi dakord, në parim? Marrim edhe propozimet e zotit Subashi, dakord?

Flamur Noka – Dua të them vetëm një gjë. Të gjithë jemi dakord për amnistinë, në parim, por momenti na bën të dyshojmë se ndoshta po përdoret për shpërblime politike, sepse e keni fill pas fushate. Ky është i gjithë shqetësimi ynë. Në parim jemi të gjithë dakord, por kam përshtypjen se po përdoret...

Spartak Braho - Mbyllim mbledhjen.

MBYLLET MBLEDHJA